



KOLEGJI - COLLEGE  
**BIZNESI**  
Prishtinë

Rregullore për pronësinë intelektuale e Kolegjit "BIZNESI" është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 "Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës", Statutin e Kolegjit neni 81, në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor i datës 29/01/2021, miraton:

## RREGULLORE PËR PRONËSINË INTELEKTUALE.

### Neni 1

Pronësia intelektuale nënkupton sipas kësaj rregullore si në vijim:

- 1.Regjistrimin e pronës intelektuale
- 2.Mënyrën ruajtjes së punimeve shkencore
- 3.Periudhën Kohore te përcaktuar për ruajtjen e të drejtës së pronësis
- 4.Të drejtat autoriale
- 5.Të Drejtat e Kolegjit

KOLEGJI "BIZNESI"  
Nr. 27-1/21 Data 29.01.2021  
PRISHTINË

### Neni 2

Kolegji Biznesi do përvec kësaj rregullore edhe ligjin për Pronësin Intelektuale (<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2643>) dhe Ligjin për të drejtat autoriale dhe të përaferta: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2787>

### Neni 3

Elementet e të drejtës së autorit, përfshin ;

1. bashkautorët dhe autorët e veprës së gërshetuar;
- 2.përmbajtjen e të drejtave pasurore të autorit dhe të drejtën në kompensim të veçantë për riprodhim privat ose tjetër vetanak;
3. marrëdhënien midis të drejtës së autorit dhe të drejtës së pronësisë mbi ekzemplarën e veprës;
4. kufizimet e të drejtës së autorit, përfshirë dhe përfshirjen e kufizimeve;
5. llogaritjen e fillimit dhe efektin e mbarimit të kohëzgjatjes së mbrojtjes të së drejtës së autorit, si dhe kalimin e të drejtës së autorit;

#### Neni 4

1. E drejta e autorit është e drejtë e pandashme e një veprë, e cila i takon autorit si subjekt i pronës intelektuale për veprën e mbrojtur.

2. E drejta e autorit përmban:

2.1. autorizimet ekskluzive personale për të mbrojtur pacenueshmërinë e veprës së autorit dhe personalitetin e autorit, në vijim: të drejtat morale të autorit;

2.2. autorizimet ekskluzive pasurore për të mbrojtur interesat pasurore të autorit, në vijim: të drejtat pasurore të autorit;

2.3. autorizimet tjera të autorit, në vijim: të drejtat tjera të autorit.

#### Neni 5

E drejta e autorit i takon autorit me vetë faktin e krijimit të veprës

#### Neni 6

1. Vepra të autorit janë krijimet intelektuale origjinale në lëmin e shkencës dhe respektohen plotësisht nga Kolegji bazuar në ligjin për të drejtat e autorit.

#### Neni 7

1. Punimet shkencore të kryera, të pambaruar e autorit, pjesët përbërëse të veprës së punës, titulli i veprës së autorit, që janë vetvetiu krijime intelektuale origjinale, gëzojnë mbrojtje si edhe vetë vepra.

2. Nuk është e lejuar të shfrytëzohet si titull i veprës një titull i cili është shfrytëzuar më parë për llojin e njëjtë të veprës, nëse një titull i tillë shkakton konfuzion në lidhje me autorësinë e veprës.

#### Neni 8

Punimet plagjiaturë do të anulohen nga Kolegji dhe do të merren masa përjashtuese nga Kolegji Biznesi.

#### Neni 9

Autori ka të drejtën ekskluzive të njihet dhe të shënohet si autor i veprës. 2. Autori ka të drejtë të vendosë nëse autorësia e tij duhet të tregohet me emër, pseudonim apo shenjë.

#### Neni 10

E drejta në integritet të veprës

Autori ka të drejtë ekskluzive ta kundërshtojë çfarëdo deformimi, apo intervenimi tjetër në veprën e tij, si dhe çfarëdo shfrytëzimi të veprës së tij, nëse një ndërhyrje e tillë do të mund ta paragjykonte reputacionin e tij kreativ dhe respektin.

## Neni 11

E drejta e shfrytëzimit dhe format e saj

1. Autori ka të drejtë ekskluzive për shfrytëzimin pasuror të veprës së tij në çfarëdo forme, si dhe t'ia lejojë apo ndalojë personave të tjerë shfrytëzimin e veprës së tij, nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

## Neni 12

1. Vepra e autorit mund të shfrytëzohet në formë lëndore, jolëndore dhe të modifikuar.

## Neni 13

E drejta e shpërndarjes

E drejta e shpërndarjes është e drejtë ekskluzive e autorit për ta autorizuar apo ndaluar vënien në qarkullim të veprës origjinale apo kopjet e veprës së tij përmes shitjes apo ndonjë forme tjetër të bartjes së pronësisë, përfshirë ofrimin e tyre publikut për qëllim të tillë.

## Neni 14

Kolegji Biznesi harton marrëveshje me autorin për publikimin , shfrytëzimin dhe shpërndarjes së punimet të tij shkencor, librit, eseve shkencore dhe publikimeve tjera si dhe shitjen si dhe kompenzimin.

## Neni 15

Kolegji Biznesi konsultohet me autorin dhe kërkon pëlqimin e tij për ribotim të librit shkencor, punimit shkencor ose eses shkencore ose ndonjë forme tjetër te punimit.

## Neni 16

Mësimdhënia

Shfrytëzimin i literaturës së jashtme

Kolegji do të bëje marrveshje me autorët për shfrytëzimin e librit te tyre , punimit te tyre shkencor, dhe format tjera të nevojës për përdorim të gjerë të punës autoriale.

## Neni 17

Kjo rregullore hyn në fuqi ne ditën e nënshkrimit nga dekani i Kolegjit Biznesi.

Kryetari i KLMSH-Dekani  
  
Prof. dr. Shyqeri Kabashi